



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT
DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 1310 Prot.

Tiranë, më 12.12 2017

DEKLARATË MJEDISORE

për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Në mbështetje të ligjit nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor" dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, ministri lëshon këtë Deklaratë Mjedisore për:

PLANIN E PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË DURRËS

Kufijtë e zonës që mbulon plani: sipërfaqja nën administrimin e bashkisë Durrës, njësitë e saj administrative.

Përdorimi i deklaratës mjedisore:

Deklarata Mjedisore nuk përjashton detyrimin, që për projekte të veçanta të parashikuara në këtë Plan, t'i nënshtrohen kërkesave të legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, për lejet e mjedisit dhe akteve të tjera normative në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Qëndrimi i ministrisë:

Plani i propozuar në parim përputhet me objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutese, të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.

Përfshirja efektive e grupeve përkatëse të interesit ka kontribuar në cilësinë e vlerësimit, ka sjellë të dhëna për analizën dhe raportin e VSM-së dhe do të mbështesë zbatimin e planit pas miratimit të tij, si dhe do të kontribuojë në një pranim më të lehtë dhe më të zbutur të projekteve përkatës.

Ndikimet e mundshme në mjedis të planit:

Gjatë zbatimit të projekteve/veprimeve, priten ndikime pozitive dhe negative. Ndikimet pozitive priten për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ndryshimet klimatike, si edhe për popullatën dhe asetet materiale. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë ndikime mbi faktorët klimatikë duke konsideruar, që mjetet e transportit do të vijnë të rinovohen në të ardhmen edhe më tej, gjë që do të sjellë si pasojë përmirësim të cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit njerëzor, midis të tjerave për më tej në pjesën pozitive të impakteve mbi popullatën dhe asetet materiale do të vijë si rezultat i zbatimit të infrastrukturës në përgjithësi, që do të bëjë të mundur pakësimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.

Përgjithësisht, shumica e ndikimeve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi zona ka veçori të theksuara diverse dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi, që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukturës, sidomos atyre me shtrirje të gjerë dhe korridoreve sipas sektorëve (transport, energji, ujë, etj.). ndikimet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgiminë kulturore dhe peisazhin. Këto ndikime do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave. Ndikime negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe ndikimet në cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonat me densitet të lartë banimi ku do të përqëndrohen edhe një sërë veprimesh në territor të ngushtë dhe kjo do të ndikojë kryesisht në fazën e zbatimit të projekteve specifike.

Vlerësimi i përputhshmërisë së objektivave:

Në vija të përgjithshme evidentohen se ndikimet e masave vepruese të planit në sektorët mjedisor rezultojnë të jenë përgjithësisht pozitiv. Plani, nga ana tjetër, nxit politika zhvilluese dhe territoriale koherente me strategjitë evropiane, të orientuara drejt qëndrueshmërisë mjedisore, ekonomike dhe sociale.

Plani i ka projektuar objektivat e vet strategjik në mënyrë prioritare ndaj kushteve mjedisore.

- Zbatimi i një plan menaxhimi të qëndrueshëm të mbetjeve urbane, e projektuar jo vetëm për përmirësimin e mjedisit si pasojë e mirëmenaxhimit të ciklit, por edhe për përmirësimin e sistemit “njeri-mjedis” e përdorimit më të përgjegjshëm të resurseve. Plani individualizon në veçanti në qytetin e Durrësit një kompleks të integruar për shkatërrimin e mbetjeve urbane, rikuperimin dhe ripërdorimin e tyre për qëllime energjie, impiantet lokale të të cilit duhet të vlerësohen në mënyrë të detajuar në fazën e projektimit në mënyrë që të minimizohet çdo efekt anësor;
- Monitorimi i cilësisë së resurseve hidrike sipërfaqësore dhe të thellësive nëpërmjet kompletimit të rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza, rritja e potencialit të impiantit

të trajtimit të ujërave të zeza komunale dhe ndërtimin të sistemeve të izoluar të trajtimit të ujërave të zeza në zonat më pak të urbanizuara rurale;

- Ulja e rrezeve natyrore nëpërmjet masave parandaluese, të identifikuar në bazë të kriterëve homogjene, në veçanti për ato pjesë të territorit që janë më të prekshme nga dalja e lumenjve nga shtrati (duke u nisur nga rritja e kapaciteti mbajtës së shtratit dhe e sistemit të argjinaturave, që përkojnë edhe me nevojat e rikualifikimit lumor) dhe për zonat bregdetare të rrezikuara ndaj erozionit;
- Përmirësimi i cilësisë së peizazhit urban dhe natyror përmes zhvillimit të sistemit bujqësor në zonat kodrinore, mbrojtja e zonave natyrore të pranishme, përmirësimi i qendrës së qytetit të Durrësit me ndërtesat e tij historike dhe përqendrimi i shërbimeve dhe aktiviteteve prodhuese në Porto Romano. Kjo duhet të zbatohet duke patur parasysh faktorët që ndikojnë në ndotjen e mundshme të ajrit dhe të ujit.

Sa për ndarjet e tjera të mjedisit, çdo veprim i pa kryer i planit gjeneron efekte të mëdha negative.

Detajimi i masave për mbrojtjen e mjedisit:

Me qëllimin për të shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis të planit në të gjithë fazat e tij duhet të zbatohen me përpikmëri të gjitha masat e mëposhtme.

- Të hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjatë zbatimit të planit, me synim mbledhjen e të dhënave për ndikimet konkrete dhe pasojat në mjedis gjatë zbatimit të tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutëse shtesë, që duhet të zbatohen për të garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky plan të hartohet brenda 6 muajve nga marrja e Deklaratës Mjedisore dhe të merret miratimi i autoriteve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit.
- Bashkia Durrës, nën mbikqyrjen e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, që zbaton dhe mbikqyr zbatimin e planit, të hartojë një raport vjetor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit, të cilin duhet ta dërgojë pranë Ministrisë së Mjedisit jo më vonë se java e fundit e muajit nëntor.
- Me qëllim lehtësimin e realizimit të programit të monitorimit mjedisor të planit mund të përdoren programe ekzistuese monitorimi, që përputhen me qëllimin e programit të monitorimit mjedisor të planit.
- Projektimi i objekteve të bazohet në parimin e teknologjisë më të mirë të disponueshme, e cila është efiçente në përdorimin e energjisë, si përdorimi i teknologjive izotermike të ndërtimit për çdo objekt të ri, po kështu edhe ato të minimizimit të përdorimit të ujit.
- Politikat dhe aktivitetet infrastrukturore, të parashikuara në Plan, të sigurojnë kohezion, efiçasitet dhe qëndrueshmëri dhe rritjen e përfitimeve për përdoruesit e kësaj infrastrukture.
- Plani duhet të nxitë realizimin e projekteve të impianteve të trajtimit të ujërave të përdorur urbane dhe në një shkallë më të gjerë duke e shtrirë këtë masë edhe në aktivitete e tjera industriale që krijojnë shkarkime ujrash industriale të ndotura dhe që ndikojnë sidomos

në cilësinë e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Të projektohet infrastrukturë bashkëkohore dhe afatgjatë të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.

- Të mbrohen vlerat natyrore të zonave në të cilat shtrihet studimi dhe të shmangen në maksimum dëmtimi i sipërfaqeve me vegjetacion natyral.
- Projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me kuadrin ligjor për mbrojtjen e natyrës, duke respektuar shkallën e mbrojtjes së zonës apo nënzonës së mbrojtur ku do të ndërhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve që gjenden në zonë, si dhe të komunikohet/bashkëpunohet me autoritet kompetente për zonat e mbrojtura për të marrë masat e domosdoshme për mos cënimin e statusit të këtyre zonave.
- Gjatë fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të projekteve/aktiviteteve specifike individuale të Planit duhet të përfshihen masa që do të lehtësojnë ruajtjen e korridoreve të kafshëve migratore. Në rastin kur projektet që do zbatohen mund të prekin zona të Mbrojtura apo mund të ndodhen në afërsi të tyre.
- Plani të marrë masa për promovimin e transportit publik të pasagjerëve që të kontribuojnë në pakësimin e shkarkimeve në ajër dhe reduktimin e ndotjes akustike.
- Të zbatohen masa zbutëse për zhvillimin e infrastrukturës, gjatë rehabilitimit/ndërtimit duhet të parashikojnë edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar “best practices”. Në asnjë rast nuk duhet të projektohet brënda, por as në afërsi të territorit të zonave të mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet në ajër dhe zhurmat ndikojnë ekosistemet dhe habitatet e llojeve nën mbrojtje. Promovimi brenda dhe në periferitë e zonave të mbrojtura duhet të jetë ngritja e infrastrukturave të lehta, që mbështesin aktivitetet pa makina, në drejtim të sporteve dhe aktiviteteve në natyrë.
- Hartimi i planeve të menaxhimit të trafikut krahas prioritizimit të zonave të gjelbërta publike, duhet të paraprijnë planet urbane të zhvillimit dhe të kenë objektiva të matshme për cilësinë e ajrit dhe uljen e ndotjes akustike.
- Të merren masa për mbrojtjen dhe mos dëmtimin e burimeve ujore që gjenden në zonën në studim.
- Në kuadër të planifikimit të menaxhimit, vëmendje e veçantë të kushtohet për integrimin e zonave të sigurisë nga përmytjet dhe atyre ligatinore, ndërkohë që masat e pyllëzimit të synojnë stabilizimin e humbjeve e tokës nga përmytjet (të zbatohet duke përdorur lloje të bimësisë autoktone, që i rezistojnë edhe përmytjeve).
- Të zbatohen kërkesat në afatet e përcaktuara kohore të legjislacionit të mbetjeve në fuqi, si dhe të bashkëpunojnë në kuadër të rrjetit të integruar të instalimeve, në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, për të bërë të mundur grumbullimin maksimal të diferencuar të mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin ose depozitimin në një prej instalimeve më të afërta, të përshtatshme me metodat dhe teknologjitë e nevojshme, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë mjedisor dhe të mbrojtjes së shëndetit publik.
- Para fillimit të zbatimit të projekteve, të zgjidhet çështja e administrimit të volumit inert që do të gjenerohet nga operacionet ndërtimore.

- Në tërësi, projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me standartet e ruajtjes së peisazhit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ku së bashku me elementët e cilësisë së mjedisit të jenë parësore duke aplikuar “best practices”.
- Gjatë implementimit të planit të vihen në zbatim masat zbutëse e propozuara në raportin e VSM-së për minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis.

Detyrime dhe sanksione:

- › Pavarsisht masave dhe rekomandimeve të kësaj Deklarate Mjedisore, gjatë zbatimit të planit është e detyrueshme të zbatohen kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi;
- › Shfaqja e elementeve të rinj ekologjike të panjohur, në kohën që kjo Deklaratë Mjedisore është dhënë, sjell si detyrim rivlerësimin e saj.
- › Nëse plani nuk është miratuar brënda 2 viteve nga data e miratimit të deklaratës, atëhere deklarata bëhet e pavlefshme dhe procedura e VSM-së fillon nga e para.
- › Në rast se ministria, strukturat e saj të varësisë, njësitë e qeverisjes vendore, apo edhe grupet e interesuara, përfshi edhe publikun, konstatojnë se plani nuk zbatohet në përputhje me vendimin për miratimin e tyre dhe nuk respektojnë kushtet e kërkesat e përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit, atëhere ministria njofton menjëherë autoritetin përgjegjës për zbatimin e miratimin e planit dhe, sipas rrethanave, i kërkon sqarimet përkatëse apo ndalimin e menjëhershëm të zbatimit deri në sqarimin e situatës.
- › Nëse pasojat në mjedis e shëndet, tejkalojnë standartet mjedisore në fuqi, atëhere ministria i kërkon autoritetit miratues e propozues të merren masat e duhura apo të konsiderohet edhe ndryshimi i planit, me qëllim që të përmbushen standartet mjedisore.
- › Për mos respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Deklaratë Mjedisore dhe të legjislacionit mjedisor në fuqi ka sanksione ligjore.

MINISTËR

Blendi KLOSI